FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION

KUVENDI I PUNËS DHE ZGJEDHOR I FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS

PROCES VERBALI DHE RAPORT I KUVENDIT TË PUNËS DHE ZGJEDHOR

Me datë 19 Janar 2025 në ora 11:00 është rimbajtur (përsëritur) Kuvendi i Punës dhe ai Zgjedhor i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës (FGJK), në hapësirat e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit në Prishtinë.

Përsëritja e Kuvendit të Punës dhe Zgjedhor të datës 21/12/2024, vjen si rezultat i gjetjeve (mangësive) nga Komisioni për vlerësim dhe licensim të federatave sportive në MKRS, shkeljes administrative nga pjesëmarrja e klubit të gjimnastikës të palicensuar (AKADEMIA E GJIMNASTIKËS FERIZAJ), anëtarët e të cilit klub kanë votuar në Kuvend. Pas marrjes së rekomandimeve nga KVLFS, FGJK njoftoj të gjitha klubet (15 klube) të cilat janë të licensuara me 29/05/2023, për përsëritjen e Kuvendit të Punës dhe atij Zgjedhor. Materiali i Kuvendit i është dërguar të gjitha klubeve nëpërmjet email adresave, dhe gjithashtu edhe nëpërmjet grupit në rrejtin social facbook messenger. Nga 15 klube të licensuara të FGJK-së, 10 klube janë përgjigjë pozitiv dhe kanë dërguar emrat e delegatëve të tyre pranë sekretariatit të FGJK-së, kurse 5 klube kanë dërguar email në federatë duke njoftuar se klubet e tyre nuk do marrin pjesë në këtë Kuvend. Gjithashtu pranë sekretariatit të FGJK-së, është dërguar vetëm një kandidaturë për Kryetarë të FGJK-së, dhe 5 nominime (emra të deleguar nga klubet) për anëtarë të bordit ekzekutiv të FGJK-së.

- **ECURIA E KUVENDIT:**

Kuvendi i punës dhe Zgjedhor i FGJK-së i datës 19/01/2025, filloj në ora 11:10, në hapësirat e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit.

Përveç delegatëve të Kuvendit të FGJK-së, prezent ishin edhe monitorus nga MKRS, Znj. Afërdita Fazlia, Z. Fatlum Grajqevci, kurse nga KOK ishte Znj. Teuta Beselica.

Kuvendin e hapi Kryetari i FGJK-së, Z. Besim Halilaj, duke ju referuar rendit të ditës si më poshtë:

1. **Hapja e mbledhjes nga ana e Kreytarit të FGJK-së**: Mbledhjen e hapi **Z. Besim Halilaj** Kryetar i FGJK-së, ku përshëndeti anëtarët e Kuvendit si dhe të pranishmit tjerë, dhe ndër të tjera spejgoi arsyen e përsëritjes së Kuvendit të Punës dhe Zgjedhor të FGJK-së.

2. **Zgjedhja e një proces mbajtësi**: në këtë pike Z. Halilaj propozoi që proces-mbajtës të jetë Znj. Elfete Gashi, dhe pasi që nuk kishte propozime tjera i njejti u hodh në votim ku anëtarët e kunvendit unanimisht votuan më anë të aklamacionit që proces mbajtës gjatë Kuvendit të Punës dhe Zgjedhor të FGJK-së të jetë, **Znj. Elfete Gashi**.

3. **Zgjedhja e Komisionit verifikues prej 3 anëtarëve:** Për zgjedhje në komisionit u propozuan 3 anëtarë e ata janë:

    1. **Besnik Latifi – Kryetar i Komisionit verifikues,**
    2. **Ard Kryeziu – Anëtar i Komisionit verifikues,**
    3. **Rizonë Mustafa – Anëtare e Komisionit verifikues.**

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
info.kosova.gym@gmail.com

KUVENDI I PUNËS DHE ZGJEDHOR I FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS

PROCES VERBALI DHE RAPORT I KUVENDIT TË PUNËS DHE ZGJEDHOR

Të tre anëtarët e propozuar u zgjodhën në mënyre unanime nga të gjithë të pranishmit sa edhe ishin prezent në kuvend, sipas Komisionit verifikues në kuvend të pranishëm ishin 28 anëtarë me të drejtë vote, nga 30 sa ishin të deleguar nga klubet e licensuara në FGJK, dhe u konstatua se kishte kuorum për vazhdimin e mbledhjes.

Anëtarët me të drejtë vote duke u bazuar në statutin e FGJK neni 15 numri dhe përcaktimi i delegatëve përcaktohet si më poshtë:

- ***a. Çdo shoqatë apo klub sportivë ka 3 (tre) delegat.***
- ***b. Çdo delegat ka të drejtën e 1 (një) vote.***

Anëtarët e Komisionit verifikues u këshilliuna nga Znj. Afërdita Fazlia, që të prezentohen dhe të shkohet më ngadal me proces, pas këshillimit, tre anëtarët treguan emrat e tyre dhe konstatuan që kishte korum për vazhdimin e kuvendit.

4. **Është miratuar procesverbali i mbledhjes së kaluar të Kuvendit të FGJK-së**, nga 28 anëtarë, nuk kishte kundër as abstenim, procesverbali i është dërguar anëtarëve të kuvendit, MKRS, dhe KOK me kohë.

5. **Shqyrtimi i aplikimeve për anëtarsim në FGJK, dhe pranimi i klubeve të reja në FGJK**, Kryetar Z. Besim Hailaj, njoftoi të pranishmit se Klubi i Gjimnastikës "DRENASI", kishte aplikuar me kohë për të qenë pjesë e FGJK-së, me gjithë dokumentacion të rregullt. Kjo pikë u votua dhe të gjithë të pranishmit votuan pro (28 anëtarë), nuk kishte kundër apo abstenim. Klubi i Gjimnastikës "DRENASI" u pranua me datë 19/01/2025, dhe se klubi nuk ka të drejtë vote në këtë Kuvend deri në Kuvendin e radhës kur edhe do të jetë i barabart me klubet tjera pasi të licensohet nga MKRS.

6. **Shqyrtimi i suspendimeve të klubeve dhe instancave tjera të FGJK-së.** Në këtë pikë Kryetari i FGJK-së, Z. Besim Halilaj njoftoj të pranishmit se gjatë procesit të licensimit të FGJK-së dhe klubeve, dy klube nuk kanë mundur që ti përmbushin detyrimet e tyre, në kompletimin e dokumentacionit të kërkuar, dhe bazuar në rekomandimet e KVLFS, është dashur që këto dy klube të suspendohen ose FGJK të mos licensohet, bëhet fjalë për Klubin e Gjimnastikës "PRISHTINA", dhe Akademia e Gjimnastikës "FERIZAJ", pasi që në këtë periudhë Akademia e Gjimnastikës "FERIZAJ", ka mbajt zgjedhje dhe ka përgatit dokumentacionin për licensim, kërkohet nga kuvendarët që këtij klubi ti hiqet suspendimi, të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenim, Klubit Akademia e Gjimnastikës "FERIZAJ", i është larguar suspendimi mirëpo nuk ka të drejtë pjesëmarrje në votim deri në licensimin e klubit nga MKRS.

   Gjithashtu kuvendarët u njoftuan se Klubi i Gjimnastikës "PRISHTINA" nuk i është përgjigjur thirrjeve për rregullimin e dokumentacit dhe se kërkohet që suspendimi për këtë klub të jëtë në fuqi, dhe të gjithë të pranishmit 28 anëtarë votuan pro, nuk kishte kundër e as abstenime, Klubi i Gjimnastikës "PRISHTINA" është i suspenduar.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
info.kosova.gym@gmail.com

KUVENDI I PUNËS DHE ZGJEDHOR I FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS

PROCES VERBALI DHE RAPORT I KUVENDIT TË PUNËS DHE ZGJEDHOR

7. **Raporti Narrativ i FGJK-së, (përfshi financat, aktivitetet, etj):** Kryetari i FGJK-së Z. Halilaj informoj të pranishmit pasi që të gjithë e kishin pasur materialin me kohë, dhe nëse ka dikush që të pyet në lidhje me raportin narrativ të FGJK-së. Ai gjithashtu theksoi që ky do jetë mandati i tij i fundit dhe se nuk do të kandidoj për Kryetar të FGJK-së, me tutje Halilaj theksoi: Si bashkëthemelues me ju, dhe Kryetarë i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës ndjehem i privilegjuar që pata këtë fat të inicojmë së bashku me shumë student, profesor dhe entuziast themelimin e Federatës së Gjimnastikës dhe kryesimin e saj deri më tani me nderë dhe krenari. Sado i vogël që është ky kontribut, më përmbushë një premtim që kisha si i ri për të gjithë Dëshmorët e rënë për Liri se vendit për të cilin ata u flijuan, vetëm të mira do t'i sjellë. Nuk do të kandidohem më për Kryetar, vlerat e krijuara më bëjnë të besoj se drejtuesit e rinj të FGJK-së do ta trasojnë rrugën tonë edhe më me sukses. Le të kuptohet se Institucioni i krijuar i takon Shtetit ndërsa individët u shërbejnë atyre. Halilaj pas fjalimit sygjeron që raporti të hidhet në votim, ku të gjithë të pranishmit votuan pro, pa asnjë kundër apo abstenim, mirëpo pas aprovimit është dhënë një këshillë nga monitoruesit e MKRS. Znj. Afërdita Fazlia, e cila theksoi që raporti financiar të jetë pikë e rendit të ditës ndaras nga raporti narrativ. Këshilla është pranuar.

8. **Raporti narrativ është aprovuar** nga të gjithë të pranishmit që votuan pro, nuk kishte kundër dhe abstenime.

8.1. Bazuar në rekomandimet e dhëna nga Znj. Afërdita Fazlia, kryetari kërkon nga kuvendarët që të votohet raporti financiar me çka të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenim.

9. **Shqyrtimi i raportit të Këshillit Mbikqyrës të FGJK-së dhe aprovimi i tij:** në këtë pikë të rendit të ditës, u ftua Z. Besnik Latifi, Kryetar Këshillit Mbikqyrës që të raportoj, duke theksuar, se gjatë mandatit të tij, nuk kishte vërejtje dhe se inkurajon FGJK-në që të vazhdojë me punë të njëjtë duke uruar suksese në të ardhmën. Pas raportimit të tij, kuvendarët unanimisht miratuan raportin e këshillit mbikqyrës, nuk kishte kundër apo abstenime.

10. **Propozimi i Komisionit zgjedhor prej tre anëtarëve:** në këtë pikë të rendit të ditës, Kryetari Z. Besim Halilaj është këshilluar që si kryetar kishte kompentencat e udhëheqjes së Kuvendit të Punës të FGJK-së deri në këtë pikë, nga kjo pikë e tutje Kuvendin duhet ta drejtoj Sekretari i Përgjishtshëm, Z. Amir Tahiraga, me çka u procedua sipas këshillës së dhënë, dhe se Sekretari i FGJK-së, rekomandoj që anëtarët e komisionit verifikues të jenë edhe anëtar të komisioni zgjedhor, të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenime, andaj anëtar të komisionit zgjedhor janë:
    - **Besin Latifi,**
    - **Ard Kryeziu,**
    - **Rizonë Mustafa,**

Anëtarët e komisionit zgjedhor, kontrolluan listën e kuvendarëve duke thirrur një nga një, dhe në fund konstatuan se në Kuvend Zgjedhor të pranishëm janë 28 anëtarë me të drejtë votë. Gjithashtu pas

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
info.kosova.gym@gmail.com

këshillës së dhënë nga Znj. Afërdita Fazlia, Sekretari i Përgjithshëm i FGJK-së, Z. Tahiraga, lexoj ***nenin 15 të statutit të FGJK-së, "Emërimi i Delegatëve":***

Anëtarët e Kuvendit të FGJK janë të detyruar të mbledhin Kuvendin e shoqatës, klubit, për të zgjedhur tre përfaqësuesit e tyre me të drejtë vote në Kuvendin e FGJK. Në mesin e tre përfaqësuesve duhet të respektohet barazia gjinore dhe etnike.

1. Anëtarët (shoqatat, klubet) dërgojnë pranë FGJK personat zyrtarë të autorizuar për përfaqësimin e tyre.

2. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin zyrtar (autorizim, prokurë) të shoqatës klubit sportiv etj, që vërteton se ai/ajo është përfaqësues me të drejtë vote.

3. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin e identifikimit.

4. E drejta e votës nuk mund t'i delegohet një anëtari tjetër.

5. Anëtarët (klubet, shoqatat) janë të detyruar që të sjellin emrat e personave të autorizuar për tu përfaqësuar me të drejtë vote në Kuvend, pranë Sekretariatit të FGJK jo më vonë se 7 ditë përpara datës së zhvillimit të Kuvendit.

11. **Propozimi i kanditatit, kandidatëve për Kryetar, prezentimi i tyre, votimi, zgjedhja e Kryetarit**: Në këtë pikë të pranishmit u njoftuan nga Sekretari i Përgjishthëm Z. Amir Tahiraga, se në Kuvend të Punës dhe Zgjedhor, klubet janë njoftuar me kohë për datën e Kuvendit të Punës dhe Zgjedhor, me kohë i është dërguar materiali, rendi i ditës, procedurat e zgjedhjeve, etj, dhe se 10 klube kanë dërguar emrat e delegatëve të tyre në sekretariatin e FGJK-së, kurse 5 klube nuk kanë dërguar emra të delegatëve e as nominime, me çka në këtë Kuvend Zgjedhor kemi vetëm një kandidat e ai është Z. Shkumbin Maqastena, i cili ftohet të bëjë prezentimin e tij pranë të pranishmëve.

Z. Maqastena, falenderoi të pranishmit, dhe shpalosi planin e tij, i cili plan nësë votohet për kryetarë të FGJK-së, do përpiqet që ta zbatoj së bashku me të gjithë në mënyrë që gjimnastika në Kosovë të shkonë përpara. Pas dëgjimit të fjalimit dhe planit të Z. Shkumbin Maqastena, dhe pasi që nuk kishte kandidat tjetër për Kryetar të FGJK-së, Sekretari i FGJK-së njoftoj të pranishmit që votimi do të bëhet me aklamacion, dhe se të gjithë të pranishmit 28 delegat me të drejtë vote votuan pro, nuk kishte kundër dhe as abstenime, dhe se Kryetar i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës për mandat 4 vjeçar zgjedhet Z. Shkumbin Maqastena.

12. **Propozimi dhe zgjedhja e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të FGJK-së, (bazuar në statut dhe rregullore te Bordit Ekzekutiv të FGJK-së):** Në këtë pikë të rendit të ditës, Sekretari i FGJK-së, Z. Tahiraga, njoftoj të pranishmit se bazuar në statutin e FGJK-së, Neni 25, paragrafi 1, Bordi Ekzekutiv i FGJK-së përbëhet nga 9 anëtarë duke përfshi edhe Kryetarin, 5 anëtar zgjedhen nga Kuvendi, kurse 3 vende kooptim i zgjedh (emron) Kryetari, FGJK ka pranuar nominimet e 5 anëtarëve për Bord Ekzekutiv të FGJK-së, e ata janë:

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
info.kosova.gym@gmail.com

- **Besnik Latifi, - nga Klubi i Gjimnastikës ”FUSHË KOSOVË”,**
- **Lisa Zeqiri, - nga Klubi i Gjimnastikës Ritmike ”POISE”,**
- **Amir Januzi - nga Klubi i Gjimnastikës ”VUSHTRRI”,**
- **Elfete Gashi – nga Akademia e Gjimnastikës ”UNIVERSITETI”,**
- **Ard Kryeziu – nga Klubi i Gjimnastikës ”OMNISPORT”.**

Pas njoftimit për të propozuarit e Bordit Ekzekutiv të FGJK-së, të njejtit unanimish u votuan nga të pranishmit nuk kishte kundër apo abstenime. Pas votimit të 5 anëtarëve të BE të FGJK-së, Sekretari i FGJK-së, kërkoj nga Kryetari i FGJK-së Z. Maqastena që të kooptoj tre emra, një këshill nga monitoruesi është dhënë që emrimi i tre anëtarëve tjerë mund të bëhët edhe më vonë në mbledhje të BE, mirëpo në fund pas diskutimit dhe njoftimit që emrat veç janë, atëherë Z. Maqastena, propozoj:

- Besim Halilaj – Nënkryetar të FGJK-së,
- Sherife Aliçkaj Qerimi – Nënkryetare e FGJK-së,
- Rizonë Mustafa – Anëtare e BE të FGJK-së,

Të gjithë të pranishmit votuan unanimisht për tre emrat e propozuar nga Kryetari, dhe se Bordi Ekzekutiv i FGJK-së u kompletua, dhe anëtarë janë:

1. Shkumbin Maqastena – Kryetar i FGJK-së,
2. Besim Halilaj – Nënkryetar i FGJK-së,
3. Sherife Aliçkaj Qerimi – Nënkryetare e FGJK-së,
4. Besnik Latifi – Anëtar i BE të FGJK-së,
5. Lisa Zeqiri – Anëtare e BE të FGJK-së,
6. Amir Januzi – Anëtar i BE të FGJK-së,
7. Elfete Gashi – Anëtare e BE të FGJK-së,
8. Ard Kryeziu – Anëtar i BE të FGJK-së,
9. Rizonë Mustafa – Anëtare e BE e FGJK-së.

13. **Propozimi i Kandidatit për Sekretar të Përgjithshëm të FGJK-së.** Në këtë pikë të rendit të ditës Sekretari i FGJK-së njoftoj të pranishmit se zgjedhja e sekretarit të FGJK-së është e rregulluar me statut të FGJK-së, në Kreun VI, neni 30, Stafi Menaxhues Administrativ, paragrafi 1, Bordi Ekzekutiv emëron stafin menaxhues sipas kritereve të përcaktuara nga Bordi Ekzekutiv the themelimi i marrëdhënjes së punës bëhet në pajtim me Ligjin e Punës, paragrafi 2. Sekretari i Përgjithshëm është organi administrativ i FGJK. Dhe paragrafi 3. Sekretarin e përgjithshëm, në bazë të propozimit të kryetarit e emëron Bordi Ekzekutiv me vendim pune pa afat të kufizuar, dhe pasi që është në kompetencë të kryetari dhe BE të FGJK-së, u propozua që zgjedhja e Sekretari të Përgjithshëm të FGJK-së të bëhet në mbledhjen e parë të Bordit Ekzekutiv të FGJK-së, edhe pse emër tjetër përveç emrit të sekretarit aktual nuk ka, sekretari aktual Z. Amir Tahiraga, vazhdon punën.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
info.kosova.gym@gmail.com

14. **Miratimi i planit të punës, kalendarit dhe atij financiar për vitin 2025:** Sekretari i FGJK-së. Z. Tahiraga, njoftoj të pranishmit që plani i punës, plani financiar, dhe kalendari i garave është dërguar me kohë dhe kërkon që të votohet edhe kjo pike, ku të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenime.

15. **Propizimi i Kosmisioneve: Këshilli Mbikqyrës tre anëtarë e zgjedh Kuvendi**, në këtë pikë Seretari i FGJK-së, njoftoj që për këtë komision janë propozuar 3 emra, siç janë:
- Doruntinë Ibrahimi,
- Endrit Hoti,
- Arbenita Oraca,

Pas dhënjes së këtyre emrave, Znj. Doruntinë Ibrahimi pyet se a përbën konflik interesi që ajo të jetë edhe anëtare e këshillit mbikqyrës edhe Selektore e Gjimnasteve?, pas përgjigjës së dhënë nga Sekretari se po paraqet konflik interesi, Z. Doruntinë Ibrahimi shpreh dëshirë që të largohet nga komisioni i këshillit mbikqyrës dhe se emri i saj të zavendësohet me dikë tjetër, andaj në vend të Znj. Doruntinë Ibrahimi, u emërua Z. Aziz Rama, dhe se të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenime.

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga;
- **Arbenita Oraca – Kryetare e Komisionit,**
- **Endrit Hoti – Anëtar i Komisionit,**
- **Aziz Rama – Anëtar i Komisionit.**

16. **Propozimi i Komisioneve: Bordi i Apelit tre anëtar e zgjedhë Kuvendi:** në këtë pikë Seretari i FGJK-së, njoftoj që për këtë komision janë propozuar 3 emra, siç janë:
- Ardita Istogu,
- Vlora Humolli Jashanica,
- Patriot Murati,

Pas dhënjes së këtyre emrave, u vërtetua se Znj. Vlora Humolli Jashanica nuk mund të nominohet për shkak se nuk është në Kuvend, dhe pas konsultës me Znj. Afërdita Fazlia, u vendos që të kërkohet nga Kuvendarët që të votojnë dhe t'i japin BE të FGJK-së këtë kompetencë, të emëroj anëtarin e komisionit të ankesave, dhe të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenime, mirëpo pas votimit është propozuar dhe është vendos që në vend të Vlora Humolli Jashanica të propozohet Z. Gzime Haliti, me çka të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër as abstenime.

Komisioni i Apelit përbëhet nga;
- **Ardita Istogu – Kryetare e Komisionit,**
- **Patriot Murati – Anëtar i Komisionit,**
- **Gzime Haliti – Anëtar i Komisionit.**

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
info.kosova.gym@gmail.com

KUVENDI I PUNËS DHE ZGJEDHOR I FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS

PROCES VERBALI DHE RAPORT I KUVENDIT TË PUNËS DHE ZGJEDHOR

17. **Propozimi i Komisioneve: Këshilli Profesional tre anëtar i emron Bord Ekzekutiv.**
18. **Propozimi i Komisioneve: Komisioni për Regjistrim tre anëtarë i emron Bord Ekzekutiv.**
19. **Propozimi i Komisioneve: Komisioni i Garave i emron dhe përcakton Bord Ekzekutiv.**
20. **Propozimi i Komisioneve: Komisioni Disiplinor tre deri në pesë anëtar i emron Bord Ekzekutiv.**
21. **Propozimi i Komisioneve: Komisioni për zgjedhjen e sportistëve të vitit emron Bord Ekzekutiv.**
22. **Të ndryshme:** Nuk kishte ndonjë diskutim apo kërkesë nga kuvendarët dhe se Kuvendi i Punës dhe Zgjedhor përfundon në ora 13:45, ku të gjithë të pranishmit bënë edhe foto të përbashkët.

KONKLUZION:

FGJK konkludon se i tërë procesi i Kuvendit të Punës dhe Zgjedhor i FGJK-së, ishte në rregull, nuk kishte tension as presion nga askush, zgjedhjet janë mbajtur në mënyrë demokratike, me çka edhe u zgjedh Kryetari dhe anëtarët tjerë të BE të FGJK-së.

FGJK ka të licensuara 15 klube, dhe se materiali dhe thirrja për Kuvend të përsëritur i është dërguar të gjitha klubeve, 10 nga klubet janë përgjigjur pozitivisht dhe kanë dërguar emrat e delgatëve të tyre në total 30 delegat, ndërsa në kuvend prezent ishin 28 delegat. Kurse 5 klube nuk kanë dërgu emra, në FGJK.

Pas mbledhjes së Kuvendit të Punës dhe Zgjedhor të FGJK-së, nga Sekretari i FGJK-së, u përgatit raporti për Departament të Sporteve dhe Komitet Olimpik të Kosovës, gjithashtu i njejti raport është përgatit nga Sekretari në gjuhën Angleze, dhe i është dërguar Federatës Ndërkombëtare të Gjimnastikës (FIG), Federatës Europiane të Gjimnastikës (EG), Federatës Mediteriane të Gjimnastikës (COMEGYM), Federatës Ballkanike të Gjimnastikës (BG), etj.

Të bashkangjitura i gjeni:

1. Kopjen e listës së anëtarëve të Kuvendit të FGJK-së, me nënshkrime 19/01/2025,
2. Fotot e bëra gjatë Kuvendit të Punës dhe Zgjedhor të FGJK-së, 19/01/2025,

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
info.kosova.gym@gmail.com

KUVENDI I PUNËS DHE ZGJEDHOR I FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS

PROCES VERBALI DHE RAPORT I KUVENDIT TË PUNËS DHE ZGJEDHOR





FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
info.kosova.gym@gmail.com

KUVENDI I PUNËS DHE ZGJEDHOR I FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS

PROCES VERBALI DHE RAPORT I KUVENDIT TË PUNËS DHE ZGJEDHOR



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
info.kosova.gym@gmail.com

KUVENDI I PUNËS DHE ZGJEDHOR I FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS

PROCES VERBALI DHE RAPORT I KUVENDIT TË PUNËS DHE ZGJEDHOR



Mbledhja e Kuvendit të Punës dhe Zgjedhor të Federatës së Gjimnastikës së Kosovës përfundoi në ora 13:30, të datës 19/01/2025

Amir Tahiraga – Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS • FGJK - KGF • KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
info.kosova.gym@gmail.com